


Tregtia e jashtme e mallrave

Shkurt 2025

Tiranë, më 17 Mars 2025: Në Shkurt 2025 eksportet e mallrave arritën vlerën 34 mld lekë, duke u rritur me 4,3 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe me 7,3 %, në krahasim me Janar 2025. Importet e mallrave arritën vlerën 68 mld lekë, duke u ulur me 8,6 %, në krahasim me një vit më parë dhe duke u rritur me 12 %, në krahasim me Janar 2025. Defiçiti tregtar i këtij muaji është 34 mld lekë, duke u ulur me 18,6 %, krahasuar me Shkurt 2024 dhe duke u rritur me 17,1 %, në krahasim me Janar 2025.

Fig.1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)




Në këtë dymujor eksportet e mallrave arritën vlerën 65 mld lekë, duke u rritur me 4,6 %, ndërkohë importet e mallrave arritën vlerën 128 mld lekë, duke u ulur me 4,7 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 63 mld lekë, duke u ulur me 12,7 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2024.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Gjatë muajit Shkurt 2025, në rritjen e eksporteve prej 4,3 %, kanë ndikuar grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +11,1 pikë përqindje, “Ushqime, pije, duhan” me +1,7 pikë përqindje, “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +0,2 pikë përqindje. Ndërsa negativisht kanë ndikuar grupet: “Materiale ndërtimi dhe metale” me -6,9 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -1,0 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” me -0,8 pikë përqindje etj.

Për publikim 17/03/2025

Fig.2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Shkurt 2025



Eksportet, gjatë këtij dymujori janë rritur me 4,6 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të eksporteve, janë: “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me +12,0 pikë përqindje, “Ushqime, pije, duhan” me +1,1 pikë përqindje. Ndërsa negativisht kanë ndikuar grupet: “Materiale ndërtimi dhe metale” me -6,3 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -1,7 pikë përqindje dhe “Produkte kimike dhe plastike” me -1,0 pikë përqindje.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:

Gjatë muajit Shkurt 2025, në rënien e importeve prej 8,6 %, krahasuar me Shkurt 2024, negativisht kanë ndikuar grupet: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me -9,6 pikë përqindje, “Prodhime druri dhe letre” me -0,4 pikë përqindje, “Lëkurë dhe artikujt prej tyre” me -0,2 pikë përqindje. Ndërsa pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +2,0 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +0,3 pikë përqindje dhe “Tekstile dhe këpucë” me +0,1 pikë përqindje.

Fig.3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Shkurt 2025



Si dymujor, importet janë rritur me 4,7 %, krahasuar me dymujorin e parë 2024. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të importeve, janë: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +1,9 pikë përqindje, “Ushqim, piye duhan” me +0,7 pikë përqindje dhe “Produkte kimike dhe plastike” me +0,4 pikë përqindje. Ndërsa negativisht kanë ndikuar grupet: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me -5,6 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -1,3 pikë përqindje dhe “Prodhime druri dhe letre” me -0,3 pikë përqindje.

Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere


Në muajin Shkurt 2025, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritjen më të madhe të eksporteve, në krahasim me Shkurt 2024 janë: Kosova (63,7 %), Greqia (10,2 %), Gjermania (7,5 %), etj. Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Italia (14,1 %), Maqedoni e Veriut (22,6 %), Austria (0,4 %), etj.

Gjatë këtij dymujori vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritjen më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Kosova (76,8 %), Gjermania (3%) dhe Greqia (6,3%). Ndërsa vendet me të cilat ka pasur uljen më të madhe janë: Italia (15,9 %) , Maqedonia e Veriut (11,0 %) etj.

Në muajin Shkurt 2025, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritjen më të madhe të importeve, janë: Kina (16,6 %), Greqia (10 %), Spanja (46,3 %) etj. Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe, në krahasim me Shkurt 2025 janë: Italia (2,5%), Turqia (41,2 %), Gjermania (12,1 %), etj.

Gjatë këtij dymujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritjen më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (1,2 %), Kina (31.1 %) dhe Greqia (6,3 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Turqia (30,4 %), Gjermania (7,8 %) dhe SHBA (37,1%).

Fig.4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Shkurt 2025



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE-së zënë 58,9 %, të gjithë tregtisë. Në Shkurt 2025, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 68,1 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 54,4 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (27,1 %), Greqia (8,3 %), Turqia (8,0 %), Kina (7,5 %).

Shkëmbimet tregtare, për dymujorin e parë 2025, me vendet e BE-së zënë 58,0 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Shkurt 2025, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 68,1 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 52,8 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (27,1 %), Kina (8,6 %), dhe Greqia (8 %).

Tab.1 Qarkullimi i mallrave, Shkurt 2025

Vitet	Muajt	Eksporte (mid lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mid lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mid lekë)	Mbulimi (%)
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626	8,1	-353	43,6
2018		310	13,7	641	2,4	-331	48,4
2019		299	-3,8	649	1,2	-350	46,0
2020		272	-9,0	605	-6,8	-333	44,9
2021		369	35,6	801	32,3	-432	46,1
2022		487	32,0	950	18,7	-464	51,2
2023		440	-9,5	873	-8,2	-432	50,5
2024		373	-15,4	894	2,5	-522	41,7
2023	01 - 23	42	20,2	58	5,8	-16	72,3
	02 - 23	38	2,8	69	1,1	-31	55,2
	03 - 23	42	-11,7	81	-3,7	-38	52,3
	04 - 23	34	-19,2	75	-3,9	-41	45,4
	05 - 23	40	-11,7	81	1,2	-41	49,2
	06 - 23	38	-17,3	75	-7,5	-37	50,7
	07 - 23	38	-4,0	71	-13,6	-33	53,7
	08 - 23	27	-21,9	68	-15,0	-40	40,6
	09 - 23	34	-12,8	73	-16,6	-40	45,8
	10 - 23	37	-4,3	78	-6,3	-42	46,8
	11 - 23	33	-21,8	72	-7,4	-39	46,0
	12 - 23	38	-6,6	73	-23,1	-35	51,7
	Jan-Dhj 23	440	-9,5	873	-8,2	-432	50,5
2024	01 - 24	30	-29,2	60	3,4	-30	49,5
	02 - 24	32	-16,1	74	6,4	-42	43,5
	03 - 24	33	-21,0	75	-7,0	-42	44,4
	04 - 24	35	1,8	75	0,6	-41	45,9
	05 - 24	35	-12,4	79	-1,6	-45	43,8
	06 - 24	35	-8,9	77	2,1	-42	45,3
	07 - 24	33	-12,0	85	21,1	-52	39,0
	08 - 24	22	-18,2	69	1,9	-46	32,6
	09 - 24	31	-8,5	71	-3,1	-40	43,3
	10 - 24	31	-15,2	77	-1,5	-46	40,3
	11 - 24	30	-8,5	73	2,0	-43	41,2
	12 - 24	26	-31,7	79	8,3	-53	32,6
	Jan-Dhj 24	373	-15,4	894	2,5	-522	41,7
2025	01 - 25	31	4,9	60	0,1	-29	51,8
	02-25	34	4,3	68	-8,6	-34	49,7
	Jan-Shk 25	65	4,6	128	-4,7	-63	50,7

Tab.2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë), Shkurt 2025

	Eksporte				Importe			
	Shkurt 2024	Shkurt 2025	Jan. - Shkurt 2024	Jan. - Shkurt 2025	Shkurt 2024	Shkurt 2025	Jan. - Shkurt 2024	Jan. - Shkurt 2025
Vendet e BE-së	23,782	22,829	46,960	44,138	37,447	36,701	66,862	67,496
Austri	210	209	462	416	748	641	1,288	1,072
Gjermani	2,072	2,227	4,074	4,197	5,698	5,006	10,015	9,235
Greqi	2,077	2,289	3,940	4,190	5,513	6,065	10,539	11,198
Itali	14,533	12,490	29,086	24,459	15,252	14,871	27,418	27,758
Spanjë	1,091	1,920	2,064	3,731	798	1,168	1,604	2,024
Kroaci	380	183	979	302	306	378	495	780
Të tjera të BE-së	3,420	3,510	6,355	6,842	9,132	8,573	15,502	15,429
Mbretëri e Bashkuar	139	93	242	203	726	661	1,211	1,178
Kinë	650	799	930	1,282	5,792	6,752	11,715	15,362
Kosovë	3,259	5,337	6,138	10,851	948	802	1,660	1,686
Maqedonia e Veriut	1,223	947	1,969	1,753	941	1,019	1,717	1,779
Rusi	-	6	-	6	320	139	393	498
SHBA	362	366	749	653	1,459	1,441	4,311	2,710
Turqi	281	718	812	1,021	12,484	7,342	18,781	13,065
Ukrainë	104	226	114	261	288	273	876	792
Zvicër	169	122	247	159	730	995	1,091	1,464
Të tjera	2,189	2,089	3,792	4,457	12,769	11,391	25,484	21,759
Gjithsej	32,159	33,532	61,952	64,783	73,904	67,516	134,100	127,789

Tab.3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë), Shkurt 2025

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Shkurt 2024	Shkurt 2025	Jan. - Shkurt 2024	Jan. - Shkurt 2025	Shkurt 2024	Shkurt 2025	Jan. - Shkurt 2024	Jan. - Shkurt 2025
Gjithsej	32,159	33,532	61,952	64,783	73,904	67,516	134,100	127,789
Ushqime. pije. duhan	3,794	4,343	7,414	8,114	11,277	11,282	21,193	22,194
Minerale. lëndë djegëse. en.el.	5,998	9,553	11,646	19,063	6,411	7,886	12,768	15,251
Produkte kimike dhe plastike	1,279	1,012	2,437	1,829	10,442	10,420	17,607	18,180
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	230	160	406	286	1,083	915	1,864	1,609
Prodhome druri dhe letre	830	814	1,617	1,567	2,601	2,302	4,314	3,955
Tekstile dhe këpucë	9,353	9,024	18,596	17,571	6,678	6,724	12,487	12,570
Materiale ndërtimi dhe metale	6,549	4,314	12,032	8,137	9,155	9,379	19,907	18,171
Makinieri. pajisje dhe pj. këmb.	3,294	3,368	6,185	6,343	22,908	15,826	38,211	30,664
Të tjera	833	945	1,619	1,873	3,349	2,781	5,747	5,195

Tab.4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Shkurt 2025

	Itali		Kosova		Greqi		Gjermani	
	2024	2025	2024	2025	2024	2025	2024	2025
Gjithsej	29,086	24,459	6,138	10,851	3,940	4,190	4,074	4,197
Ushqim, pije duhan	2,521	2,294	750	860	693	794	300	324
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	2,008	516	1,795	8,522	492	755	1,511	1,068
Produkte kimike dhe plastike	1,052	661	520	364	138	122	3	7
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	348	241	1	9	44	18	0	0
Prodhime druri dhe letre	906	878	208	163	247	243	22	18
Tekstile dhe këpucë	13,961	12,775	32	10	1,434	1,372	1,629	1,932
Materiale ndërtimi dhe metale	4,069	3,349	2,388	421	725	701	114	153
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	3,331	2,847	237	348	36	39	437	602
Të tjera	891	899	207	155	131	146	59	94

Tab.5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Shkurt 2025

	Itali		Turqi		Kinë		Greqi	
	2024	2025	2024	2025	2024	2025	2024	2025
Gjithsej	27,418	27,758	18,781	13,065	11,715	15,362	10,539	11,198
Ushqim, pije duhan	4,400	5,002	864	813	341	326	2,793	2,771
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	230	2,106	1,601	952	3	5	1,717	2,662
Produkte kimike dhe plastike	3,566	3,320	1,896	1,779	982	1,335	2,021	1,956
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	1,457	1,235	51	51	141	146	42	21
Prodhime druri dhe letre	874	947	722	704	243	262	552	560
Tekstile dhe këpucë	5,369	5,314	1,703	1,432	2,018	2,094	1,049	1,069
Materiale ndërtimi dhe metale	3,368	3,168	4,565	5,170	1,503	3,148	1,388	1,296
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	6,729	5,436	6,730	1,515	5,388	6,823	513	615
Të tjera	1,425	1,230	650	650	1,095	1,223	464	249

Metodologjia

Tregtia e Jashtme e mallrave është një publikim periodik mujor që paraqet tregtinë e mallrave të Shqipërisë me vendet e tjera të botës. Të dhënat e përpunuara nga INSTAT për këtë publikim janë të dhëna administrative të cilat merren nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Definicionet:

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv ose të rieksportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri